



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 19.03.2020

24-06-2020
02/218

PROCESVERBAL

i mbledhjes së I-rë (parë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -X- të vitit 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/42 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, përpërkrahjen financiare për tri vite të strehimores “Shtëpisë së Sigurt” në Gjakovë.
3. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/570 datë:21.10.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/237, përcaktimin e lokacionit “Park të Memorialit të UÇK-së” në Malishevë, sipas raportit të vlerësimit nr.020-396/24 datë:27.12.2019 të MAPL-së.
4. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/571 datë:21.10.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/230 datë:10.04.2019, për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit “Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit” në Lagjen Matoshi në qytezën e Malishevës, sipas raportit të vlerësimit nr.020-396/23 datë:27.12.2019.
5. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/599 datë:06.11.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/451 datë:22.07.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kullës së Sefë Mleqanit në fshatin Mleqan, Komuna e Malishevës, sipas raportit të vlerësimit nr.020-833/11 datë:04.12.2019 të MAPL-së.
6. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/602 datë:06.11.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/556 datë:02.10.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhes për fëmijë në fshatin Kijevë, sipas raportit të vlerësimit nr.020-1035/9 datë:04.12.2019.
7. Shfuqizimi i vendimit nr.02/520 datë:12.09.2019, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokëndërtimore të z. Kaqanik Balaj nga fshati Zabllaq Komuna e Istogut, sipas vlerësimit nr.3817/2 datë:26.11.2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

8. Shfuqizimi i vendimit nr.02/521 datë:12.09.2019, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokëndërtimore të z.Egzon Gashi nga fshati Ngucat Komuna e Malishevës, sipas vlerësimit nr.3818/2 datë:26.11.2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
9. Rishqyrtimi i Rregullores nr.02/14 datë:10.01.2020, për Transparencë në Komunën e Malishevës, sipaskërkesës nr.020-1758/3 datë:27.01.2020 të MAPL-së.
10. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019 dheshuma e mjeteve të cilat kanë kaluar në suficit.
11. Paraqitja e listës së përfituesve me farëra dhe plehra për mbjelljet vjeshtore për vitin 2019.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/654 datë:27.11.2019, për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2020.
 - Komitetit për Komunitete.
 - Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
 - Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
 - Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës.
 - Komitetit për Diasporë.
 - Komisionit Komunal të Aksionarëve.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2019.
15. Formimi i Komisionit për Hartimin e Rregullores për Kriteret e Ndarjes së Çmimeve, Dekorativitet dhe Mirënjohjeve.
16. Gjendja aktuale në Gjimnazin “Hamdi Berisha” në Malishevë.
17. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 07.02.2020 dhe filloi në ora 10:22 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 17 asambleistë, drejtorë komunalë, LMT-ja, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë ju të pranishëm! Sot është mbledhja e I-rë për këtë vit, korrumin e kemi dhe mund të fillojmë. E dhapi debatin e para rendit të ditës.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Me 28 janar të këtij viti ra në detyrën e tij duke u ballafaquar me grupe kriminelësh Sami Thaqi. Ne Samiun do ta kujtojmë si hero të luftës dhe të paqes. Vepra dhe kontributi i bashkëvendësit tonë gjithëmonë do të kujtohet me krenari. Andaj si asambleist i këtij Kuvendi kërkoj 1 min heshtje për kontributin dhe veprën e Sami Thaqit!

Hidajete Mazreku: E mbajmë 1 min heshtje për ta nderuar veprën e policit Sami Thaqi.

Lavdi!

Ngushëllime familjes në emër të Kuvendit Komunal në Malishevë!

Alban Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ky vit ka filluar me një numër të madh problemesh në nivelin lokal. Këtu po vërehet mungesa e Kryetarit, Kryesuesit dhe një pjesë e delegacionit të anëtarëve të Kuvendit e që janë në një vizitë private e që është sponsorizuar me mjete publike. Kam qenë dësmitarë i këtij procesi dhe e kanë nis gabim e me shkelje të rënda duke e dëmtuar edhe buxhetin e komunës. Për herë të parë kjo vizitë jashtë vendi bëhet për një biznes privat. Ky biznes është në kuadër të bizneseve që ne në mbledhjet e kaluara ju kemi thënë jo në K. e Malishevës siç është fabrikë e riciklimit të mbetjeve. Skenari është që ajo fabrikë nesër të vije këtu si një ofertë për hapjen e bizneseve të reja nga jashtë për mbeturina. Duke u nisur nga provoja e dimë se çka pritët nga kjo si në rastin e asaj kompanie në Dragobil. Një dështim i plotë e që nuk funksionon këtu.

Kjo fabrikë nëse hapet këtu do të ketë shumë pasoja sepse këtu duhet të përpunohet bërllogu i krejt dyjasësi qender e përpunimit të mbeturinave. Kjo vizitë është edhe konflikt interesi dhe është papërgjegjësi e atyre që kanë shkuar, prandaj i kërkoj të gjitha ato dokumente që janë për këtë vizitë ta shohim sa çka është kjo vizitë dhe a ka konflikt interesi që edhe ka.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Së pari nuk kam lidhje me agjendën e Kryetarit, Kryesuesit dhe disa të tjerëve që janë në atë vizitë në Itali, sigurisht ata do të sjellin një raport ose do t'na sqarojnë që a është zyrtare kjo vizitë. Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit thuhet që seancat mund të thirren me 1/3 e kërkesës së asambleistëve dhe veç në raste të tilla mund që anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal ta udhëheq mbledhjen jo si ju në këtë rast që kjo është thirr një mbledhje e rregullt nga Kryesuesi.

Fshatrat Kjevë, Bubavec e disa të tjerë kanë problem për energji elektrike ku për këtë kemi mbajtur edhe një protestë në Kjevë dhe ka shumë herë që këtë çështje po e diskutoj këtu. Rryma është tepër e dobët dhe të gjitha ato biznese në Kjevë shërbimin e kryejnë me gjenerator. Kërkoj që kjo çështje në formë kërkesë të bëhet nga Kuvendi Komunal t'i drejtohen KEDS-it për shërbimet që pi paguajnë qytetarët e që nuk po i marrin.

Në rendin e ditës është e 5-ta herë që na paraqitet një kërkesë për Bujqësinë e që të gjithë e dimë që nuk ka pasur listë oër farëra dhe plehëra.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Drejtor i Arsimit shkolla fillore "Hilmi Hoti" që 2 javë nuk ka ujë të pijes, a jeni të informuar ju? A do të ndërmerri diçka për këtë rast?

Për objektin e xhamisë që është ndërtuar në fshatin Llozicë ku as Bashkësia Islame e as fshati nuk kanë sjellë kërkesë për ndarjen e lokacionit, por ata e kanë marrë një ljeje nga drejtori i Urbanizmit për ndërtim pas pasur pronë. Kërkoj nga drejtori i Urbanizmit t'na sqaroj se si ju dha leja e ndërtimit për një objekt kur s'ka pronë, pse ai nuk i ka kërkuar të gjitha dokumentet e duhura?

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Kam një pzetje për ju drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Drejtorja e shkollës së Astrazubit ka parashtruar disa kërkesa për ju e kjo e fundit ka të bëjë me ngrohjen qendrore që kemi shumë shqetësime së fundit për të. Problem tjetër për këtë shkollë është edhe kundërmimi i kanalizimit e ju nuk keni ardhur për inspektim. Një nga keto mbledhje i kam paratur edhe disa kërkesa të drejtorisë së shkollës sonë drejtuar juve por nuk e di a i keni marr ato kërkesa por përgjigje nuk keni marrë.

Hidajete Mazreku: Drejtori i Drejtorisë së Arsimit po kërkon fjali pasi paska një agjendë tjetër dhe nuk mund të jetë këtu më vonë.

Blerim Thaçi: Pershendetje për të gjithë! Ilaz, veç sa kam ardhur nga shkolla “Hilmi Hoti” dhe në atë shkollë i kam edhe fëmijët e mi. Nëse në atë moment nuk ka gjendje për mësim sigurisht që mësimin do ta ndërpreja. Gjendja është normale dhe shkolla çdo ditë furnizohet me ujë sot e kemi dërguar edhe një cisternë me ujë deri sa t’i përfundojme procedurat e tenderimit dh i kalojmë telashet me buxhet dhe e rregullojmë këtë çështje. Procedurat kanë filluar dhe ujë shkolla nuk ka shkakun i thatësisë dhe shpresojmë që brenda 2 javë hapet edhe pusi i ri. Për çështjen e grohjes qendrore për shkollën e Astrazubit ne e kemi pasur një ankesë, por ngrohja është funksionale por nuk ka kapacitetet për ta ngrohur sa duhet shkollën. Por asaj shkolle i është bërë pranimi teknik me atë ngrohje. Ne duhet t’i kontrollojme radiatorët se si funksionojnë dhe ta zgjidhim këtë problem.

Hidajete Mazreku: Sapo mora një lajm të hidhur. Sot ka ndërru jetë e madhja Nexhmije Pagarusha, kërkoj 1 min heshtje për ta nderuar kontributin dhe vlerat e saj që la në artin dhe muzikën shqipe.

1 min heshtje

Falemnderit! Në emër të Kuvendit Komunal i shprehim ngushëllime familjes!

Vazhdojmë me mbledhjen.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! I shprehi ngushëllime familjes dhe gjithë kombit shqiptar sepse të gjithë e njohim vlerën e saj!

Pasi është mbledhja e parë për këtë vit uroj që ky vit të jetë i sukseshëm në të gjitha fushat. Suksese i uroj suksese edhe qeverisë së re në nivelin qendror dhe ta shohim sa apo i mbajnë premtimet dhe çka do të bëjnë për K. e Malishevës.

Projekti i ujësjellësit në fshatin Pagarushë ka mbetë në gjysë dhe shpresoj që në këtë vit do të reflektojnë sepse gypat kanë mbetur mbi tokë. Shqetësime kemi edhe për ndriçimin publik sepse disa nga ato nuk punojnë.

Çështja e vizitës në Itali mendoj që është dashur njëherë që të diskutohet këtu në Asamble e të aprovohet këtu ajo vizitë.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Të përgëzoj për udhëheqjen e kësaj seance Kryesuese. Ne me grupet politike këtu u morëm vesh që kjo seancë të ndërpritet shkakun i shkeljeve të procedurave.

Këtu u ngriten disa shqetësime nga kolegët e mi siç është edhe çështja e emergjisë elektirike e që është edhe shqetësim i joni jo veç i qytetarëve. Është mirë që ne si Kuvend Komunal t’i drejtohem me një shkresë menaxherit të KEDS-it për këtë shqetësim e të shohim se çka do të bëhet më pas.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Pavarësisht që Kryetari, Nënkryetari dhe drejtori i Finacave nuk janë këtu unë do t’i bëjë disa pyetje. Ka më shumë se një vit që Muzeu i Qytetit është pa energji elektirke. Aty janë të vendosura edhe kamerat e sigurisë që për shkak të mungesës së rrymës nuk kanë funksionuar as ato. Jemi në muajin shkurt dhe komuna jonë nuk ka kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës dimërore. Ku qëndron problemi që komuna jonë s’ka mirëmbajtje të rrugëve gjatë dimrit?

Ndriçimi publik në rrugën “Skenderbeu” aty është rrëzuar një shtyllë e fare nuk është intervenuar për rregullimin e saj. Gjithashtu edhe pse është bërë një investim në Parkun e Qytetit aty në

mbrëmje nuk funksionojnë disa drita fare. Ka shumë rrugë të dëmtuara në qytet siç ajo për të Shtëpia e Shëndetit është një katrahurë e që po rrezikohen edhe pjesëmarrësit në komunikacion si dhe te hyrja e shkollës fillore "Ibrahim Mazreku" rruga është në gjendje të mjerueshme.

Në mbledhjen e kaluar të bordit të drejtorëve, drejtori i Finacave thotë që të hyrat vetanake për 5% në këtë vit se sa ato që kanë qenë të palnifikuara për këtë vit. Drejtor, sa janë rritur borxhet e Komunës së Malishevës për vitin 2019? Ne dyshojmë që këto borxhe kanë shkuar mbi 3mil euro që komuna ka ndaj kompanive të ndryshme etj.

Drejtor i Shërbimeve Publike kam një kërkesë për vendosjen e shenjave të komunikacionit nëpër rrugë, të paktën biles nëpër qytet.

Ne po pajtohemi që kjo senacë mos të vazhdojë më tutje, por të mbahet në javën tjetër.

Hidajete Mazreku: Në bazë të konsultimeve të shpejta të grupeve kërkohet që kjo seancë të ndërpritet sot dhe të vazhdojë të Premtën në ora 10 po me këtë rend dite. Me kaq për sot këtë seancë e shpalli të mbyllur

Mbledhja përfundoi në ora 11:15

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes: Hidajete Mazreku

*

*

*

Vazhimi i mbledhjes së I (parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës

Mbledhja mbahet me datë 21.02.2020 dhe filloi në ora 10:37 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 16 asambleistë, drejtorë komunalë, LMT-ja, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Të pranishëm jemi 16 asambleistë, kuorrumin e kemi dhe mund të vazhdojmë me mbledhje e I-rë për këtë vit e që është shtyer që 2 herë kjo mbledhje. Kam një kërkesë që në rendin e ditës të futet një pikë e re është një shkresë e kthyer nga MAPL-ja, pra: Rishqyrtimi i vendimit nr. 02/13 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Odës në fshatin Astrazub. Ne i kemi edhe 4 kërkesa të tjera të cilat janë kthyer nga MAPL-ja për

shkak që nuk harmonizohen me PSHK-në. Ata kërkojnë që këto kërkesa të harmonizohen me PSHK-në, të futen në preambulë dhe në përshkrimin e vendimit të ceken nenet që janë të harmonizuar me PZHK-në. Këto vendime janë: ndarja e lokacionit për Memorialin e UÇK-së, Oda në Malishevë, Çerdhja në Kjevdë dhe Kulla e Sef Mleqanir. Pra këto 5 vendime kërkojnë që të harmonizohen me PZHK-në.

Në javën e kaluar është debatuar jashtë rendit të ditës dhe tani na mbetet që të diskutojmë për rendin e ditës. E hapi debatin për rendin e ditës.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! E kam thënë edhe në javën e kaluar që pika e 11-të duhet të largohet nga rendi i ditës e cila është e përsëritur që disa herë sepse Drejtoria e Bujqësië ka deklaruar që nuk e ka një listë të tillë dhe me ato mjete janë paguar disa obligime.

Alban Krasniqi: Ato pika që janë aedh nga MAPL-ja janë të karakterit teknik ku duhet të plotësohen preambulat dhe të bëhet harmonizimi me PZHK-në. Ne në vitin e kaluar kemi pas marrë një vendim që të obligohet Drejtoria e Urbanizmit që t'na bëjë një prezantim të PZHK-aë para nesh. Por ai prezantim nuk është bërë kurrë e ne nuk jemi të informuar që kur të marrim ndonjë vendim ta bëjmë edhe harmonizimin më të.

Mendoj që pika e 11-të nuk duhet që të hiqet nga rendi i ditës sepse në raportin e Drejtorisë së Financave aty figuron që këto mjete janë shpenzuar për këtë qëllim. Ne nuk kemi një dokument se ku janë shpenzuar këto mjete. Deri sa ato informacione si kemi kjo pikë do të diskutohet. Ne punën tonë e bazojmë mbi dokumente.

Rrahim Morina: Sylë, kjo pikë e rendit të ditës ka qenë kërkesë e KPF-së.

Alban Mazreku: Pershennsetje për të gjithë! Ne grupi ynë pajtohemi me këtë rend dite ashtu siç është dhe pajtohemi me kërkesën e Kryesuesit për shkresën e MAPL-së.

Valon Krasniqi: Edhe ne LDK-ja pajtohemi me këtë rend dite si dhe me kërkesën e Kryesuesit.

Rrahim Morina: Pasi s'ka diskutues të tjerë, shkojmë me votim. Sylja propozoi që pika e 11-të të hiqet nga rendi i ditës, kush është për?

Për: 7

Kundër: 14

Abstenim: 0

Me këtë votim pika e 11-të mbete në rendin e ditës.

E hedhi në votim kërkesën time, Rishqyrtimi i vendimit nr. 02/13 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Odës në fshatin Astrazub. Kush është për?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me të votim kjo kërkesë hyn në rendin e ditës dhe vendoset si pika e 7-të.

Atëherë po e hudhi në votim rendin e ditës në tërësi me plotësime. Kush është pro këtij rendi të ditës?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 7

Me këtë votim aprovohet edhe rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -X- të vitit 2019. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka diskutues atëherë kush është pro miratimit të procesverbalit të mbledhjes së -X- të vitit 2019?

Për: 22 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/42 datë:20.01.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, përpërkrahjen financiare për tri vite të strehimores "Shtëpisë së Sigurt" në Gjakovë. E hapi debatin për këtë pikë edhe pse Kryetari nuk është këtu.

Sylë Dukolli: Mendoj që kjo pikë duhet të përkrahet edhe ashtu vlera nuk është shumë e madhe dhe është një bashkëpunim në mes institucioneve. Kërkesën të gjithë e kemi dhe njëkohësisht është pjesë e humanizmit e ne duhet ta përkrahim.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kjo shtëpi është regjionale dhe mendoj që duhet ta përkrahim sepse e dimë se sa është dhuna e pranishme në familje. Investimi në këtë rast është shumë i rëndësishëm. Vitin e kaluar e kam vizituar personalisht këtë shtëpi dhe jam e njoftuar me gjendjen atje. Ne duhet të krijojmë mekanizma që për disa familje të sigurojmë banimin këtu për shkak të ndjeshmërisë së rasteve ku ka nëna me fëmijë të moshave të ndryshme. Shqetësues janë fëmijët aty, ata kanë vështërsi edhe në shkollë. Kjo shumë më duket mua simbolike sepse ne duhet të bëjmë më shumë sepse ne kemi gra aty. Ne për këtë duhet të brengosemi.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Shumë keq që Kryetari nuk është këtu! Ne çdo çështje e kemi diskutuar me seriozitet dhe më përgjegjësi të madhe. Edhe këtë kërkesë për përkrahjen financiare për këtë strehimore do ta mbështesim ne si grup PDK-ja. Urojmë që të ketë sa më pak raste dhe të gjejmë mundësinë për të evindentuar ato raste që janë të fshehura, e më të vertetë të jenë të sigurtë në këtë strehimore të sigurtë!

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë për mbulimin e shpenzimeve për 3-mujorin e parë dhe shpenzimet e tilla janë të mbuluara nga niveli qendror, mirëpo gjithmonë shkaku i buxhetit ka pak probleme në fillim të vitit. Çdo herë që kërkohet një ndihmë e tillë ne do ta përkrahim. Ne si komunë jemi shumë të hendikepuar sa i përket informimit nga KKSBB që i trajton këto çështje. Ne në mbledhjen e fundit të KPF-së kemi kërkuar që KKSBB-ja t'na jap informacione të detajuara për të gjitha problematikat që ndodhin në K. e Malishevës dhe na ta kemi një pasqyrë më të qartë. Ne ende i ndrydhim dhe i fshihim këto probleme e që nuk është në rregull sepse veç duke u ballafaquar me to, e njohur me kohë mund t'i zgjidhim ato.

Valon Krasniqi: Për grupin tonë nuk ka rëndësi se kush parashtron kërkesa, kur ato prekin interesat e qytetarëve ne gjithmonë i përkrahim, sikurse si e përkrahim edhe këtë kërkesë të parashtruar nga Kryetari Begaj.

Rrahim Morina: Meqenëse të gjitha grupet po e përkrahin këtë kërkesë, drejtor saktëson se nga cilë zë buxhetor do të merren paratë.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kjo iniciativë ka ardh si rezultat i një takimi që kemi pasur me OSEBE-në që kanë kërkuar që edhe K.e Malishevës të përfshihet në kuadër të këtyre pagesave. Kjo sipas kategorisë së shpenzimit i takon kategorisë së Subvencioneve dhe ne e kemi këtua mundësi pasi e kemi rritur buxhetin e kategorisë së subvencionve për vitin 2020. Keto mjete mund t'i marrim nga Drejtoria e Bujqësisë, në kategorinë e subvencionve e t'i ridestinojmë për këtë qëllim. Kodin mund t'ju sjellë me shkrim nëse doni. Por me kërkesën e juaj mund t'i marrim edhe nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve apo diku tjetër.

Rrahim Morina: Jemi në procedurat e votimit për këtë kërkesë. Kush është pr miratimit të kërkesës nr.01/42 datë:20.01.2020 të parashtuar nga Kryetari i Komunës, për përkrahjen financiare për tri vite të strehimores “Shtëpisë së Sigurt” në Gjakovë dhe mjetet të merren nga kategoria mallëra dhe shërmime nga Drejtoria e Shëndetësisë?

Për: unanimisht

Sipas Udhëzimit Administrativ e që harrova në fillim duhet ta konstatoje praninë e asambleistëve në këtë mbledhje. Mungon Genc Shurdhaj, Faik Zogaj, Abetare Limaj dhe Kastriot Berisha pa leje, Dianë Hoti, Leonitë Kastrati, Behije Sertolli më kanë informuar për këtë mungesë.

Të nderuar asambleistë të 5 kërkesat që janë me radhë, pika e 3-të, 4-ërt, 5-të, e 6-të dhe e 7-të e rendit të ditës janë të natyrës së njëjtë ku kërkohet që në Preambulë të futet harmonizimi i Ligjit për Planifikimin Hapësiror dhe PZHK-së kjo duhet të përshkruhet edhe në vendim. Prandaj mendoj që t'i votojmë në pako të tëra e ndërsa vendimet t'i njerrim një për një.

Muharremi po kërkon që t'i votojmë një nga një dhe të nxjerret vendimi një për një.

Kalojmë pra në pikën e 3-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit nr.02/570 datë:21.10.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/237, përcaktimin e lokacionit “Park të Memorialit të UÇK-së” në Malishevë, sipas raportit të vlerësimit nr.020-396/24 datë:27.12.2019 të MAPL-së. Kush është për?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit nr.02/571 datë:21.10.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/230 datë:10.04.2019, për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit “Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit” në Lagjen Matoshi në qytezën e Malishevës, sipas raportit të vlerësimit nr.020-396/23 datë:27.12.2019. Kush është për?

Për: unanimisht (20)

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit nr.02/599 datë:06.11.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/451 datë:22.07.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kullës së Sefë Mleqanit në fshatin Mleqan, Komuna e Malishevës, sipas raportit të vlerësimit nr.020-833/11 datë:04.12.2019 të MAPL-së. Kush është për?

Për: unanimisht (20)

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit nr.02/602 datë:06.11.2019, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02/556 datë:02.10.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhes për fëmije në fshatin Kijevë, sipas raportit të vlerësimit nr.020-1035/9 datë:04.12.2019. Kush është për?

Për: unanimisht (20)

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit nr. 02/13 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Odës në fshatin Astrazub. Kush është për:

Për: unanimisht (20)

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shfuqizimi i vendimit nr.02/520 datë:12.09.2019, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokëndërtimore të z. Kaqanik Balaj nga fshati Zabllaq Komuna e Istogut, sipas vlerësimit nr.3817/2 datë:26.11.2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.Drejtor i Gjeodezisë para se të hymë në debat kërkoj sqarim rreth kësaj pike.

Bashkim Krasniqi: Në bazë të ligjit dhe udhëzimit administrativ klasi i tokës prej 1-4 nuk lejohet ndërrim-destinimi veç në përjashtim kur komuna e ka në PZHK që atë zonë e ka paraparë për ndërtim për këtë arsyeje po i kthen MAPL-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit. Pra sipas këtyre dispozitave ligjore ne nuk mund ta bëjmë ndërrim-destinimin e totës.

Muharrem Morina: Këtë veç e tha drejtori. PZHK-kën e kanë ministria dhe çdo kërkesë për ndërrim-destinim ata e shikojnë në PZHK se për çka është e planifikuar ajo.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Vlenë ajo që e thash më herët për PZHK-ën. Ne është dashur paraprakisht ta kemi një tryezë informuese nga Drejtoria e Urbanizmit. Po si ta kemi një sesion informues kur vet Drejtoria e Urbanizmit nuk e paska të qartë se si funksionon kjo ligjërisht?! Ne në vazhdimësi po kërkojmë që t'ju përmbahemi ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve për ndërrim-destinim të tokës bujqësore në ndërtimore, e neve në vazhdimësi na vin shkresa prej MAPL-në për shkeljen e ligjeve nga drejtoritë përkatëse, pra na qesin para një akti të kryer. Në vazhdimësi në shumicën e mbledhjeve mungon Kryetari dhe Nënkryetari, kjo është e papranueshme. Ky është një injorim ndaj nesh dhe qytetarëve dhe një papërgjegjësi e plotë ndaj atyre që e kanë votuar sepse këtu po diskutojmë këtu çështjet e tyre. Pra drejtorët dhe Keyetari Begaj nuk po i kryejnë detyrat ashtu siç i kanë të parashikurara e që i kanë obligim. Nëse doni që t'i kryeni punët që ju takojnë, ndërrojeni qasjen dhe hajdeni këtu i diskutojmë çështjet dhe ju japim zgjidhje ashtu siç duhet përndryshe jepni dorëheqje sepse këtu na sjellin kërkesa që janë në kundërshtim me ligjin dhe kërkojnë që t'i votojmë.

Arbëreshë Krasniqi: Kërkoj që kërkesat për ndërrim-destimin të trajtohen më seriozisht dhe të kenë një fokus të veçantë. Kjo mund të bëhet me argumente të sigurta në bazë të respektimit të ligjeve.

Sa i përketë NISMA në Malishevë ka bërë punë të mira dhe do të vazhdojë që t'i bëjë ato punë të mira. Ne këtu do të jemi me mandate të tëra dhe ne do të punojmë shumë në dobi të qytetarëve dhe është mirë që mos ta ndërlihim çështjen e mandateve të qeverisjes me çështjet të cilat po i diskutojmë sot këtu.

Alban Krasniqi: Çështja për të cilën diskutova është që në vazhdimësi janë shqetësime që po përsëriten dhe në vazhdimësi po kemi probleme të tilla.

Alban Mazreku: Mendoj që përveç atyre që u diskutuan këtu papërgjegjësi për këtë vendim është edhe e Ministrisë së Bujqësisë sepse te lloji i aktit shkruan: Kuvendi të Komunës së Prizrenit. Ne tani a kemi për të votuar për Prizren apo për Malishevë?! Është mirë që ne ta kthejmë këtë rekomandim të Ministrisë së Bujqësisë për Kaqanit Balaj dhe le ta përmirësojnë e pastaj le ta bien këtu, e ne tani marrim vendim. Pra propozoj që të kthehet ky vendim e të përmirësohet, e pastaj të vie këtu.

Rrahim Morina: Alban Mazreku propozoi që ky vendim për Kaqanik Balaj t'i kthehet përsëri për ta përmirësuar. Muharremi thotë që nuk ka nevojë për votim, veç e dërgojmë përsëri në Ministri për përmirësim.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Shfuqizimi i vendimit nr.02/521 datë:12.09.2019, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokëndërtimore të z.Egzon Gashi nga fshati Ngucat Komuna e Malishevës, sipas vlerësimit nr.3818/2 datë:26.11.2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Pra mbase gabimi është i njëjtë përsëri edhe këtë e kthejmë në Ministri.

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i Rregullores nr.02/14 datë:10.01.2020, për Transparencë në Komunën e Malishevës, sipaskërkesës nr.020-1758/3 datë:27.01.2020 të MAPL-së. Për këtë fjalën e ka Nebih Bibaj si Kryesues i Komisionit për hartimin e kësaj rregulloreje.

Nebih Bibaj: Ne e kemi pranuar vendimin e MAPL-së për ndryshimin e dytë të kësaj Rregullore te paragrafi i 4-ërt, neni 27 i Rregullores për Transparencë në K. e Malishevës. Ky është përmirësimi: Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike, apo në rast të heshtjes, apo mospërgjigjies së institucionit publik, kërkuesi mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë mbrenda afatit prej 15 ditësh prej pranimit të vendimit për refuzim ose për aprovim të pjesëshëm të kërkesës së tij.

Pika 2 e cila është harmonizuar me ligjet është neni 9 i kësaj Rregullore për standardet minimale të konsultimit publik në komunën sipas të cilit në çdo komunë përgjegjës të procesit për

konsultim publik është Njësia, Zyrtari për Komunikim Publik. Pra kjo është rregulluar dhe kërkoj nga ju kolegë asambleistë që ta votoni këtë rregullore.

Rrahim Morina: Atëherë shkojmë në votim për përmirësimet që i lexoi Kryesuesi i Komisionit për Hartimin e Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës. Kush është pro aprovimit të kësaj rregullore?

Për: 18 (unanimisht)

Me votim unanim u aprovua Rregullorja për Transparencë në Komunën e Malishevës me të gjitha përmirësimet.

Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019 dheshuma e mjeteve të cilat kanë kaluar në suficit. Kjo pikë është shtyer që 2-herë, drejtori përsëri nuk është këtu me kërkesën e juaj këtë pikë po e shtyejmë pas pushimit të drekës për këtë mbledhje.

Atëherë kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Paraqitja e listës së përfituesve me farëra dhe plehra për mbjelljet vjeshtore për vitin 2019. Gjithashtu edhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë nuk është këtu. Mirë, me kërkesën e juaj edhe këtë pikë e shtyejmë pas pushimit të drekës.

Atëherë kalojmë në pikën e 13-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komiteteve dhe Komisioneve për vitin 2020.

- Komitetit për Komunitete.
- Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
- Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
- Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës.
- Komitetit për Diasporë.

Komisionit Komunal të Aksionarëve. E hapi debatin për këtë pikë. Mirë, mbase s'ka diskutues shkojmë në votim.

Kush është pro miratimit të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete?

Për: unanimisht (18)

Kush është pro miratimit të Planit të Punës së Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport?

Për: unanimisht (17)

Kush është pro miratimit të Planit të Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara?

Për: unanimisht (17)

Kalojmë për diskutimin e Planit të Punës të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës si dhe Martirë të Luftës. Fjalën e ka Ilaz Krasniqi.

Ilaz Krasniqi: Ky Komitet në planin e punëve të veta e ka paraparë edhe çështjen e Muzeut të Qytetit. Ka shumë shqetësime në lidhje me Muzeun, ka mungesë të rrymës, ai muze nuk kish as pëlqim nga Komuna. Kërkoj nga administrata e Kuvendit që projektin e Muzeut ta gjejnë e të behët diçka e të rregullohet rryma në bazë të atij projekti.

Rrahim Morina: Kush është pro miratimit të Planit të Punës të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës si dhe Martirë të Luftës?

Për: unanimisht (20)

Kalojmë tek Komiteti për Diasporë, e hapi debatin.

Luan Kryeziu: Ne në këtë pikë kemi të bëjmë me shqyrtimin dhe miratimin e planeve të punës së komiteteve të Kuvendit. Do të ishte mirë që këto komitete ta kishin sjellë këtu Raportine e tyre të punës për vitin 2019. Ne dimë që këto komitete ndikojnë në punën tonë, por ne nuk po dimë se çfarë kanë bërë ato me punën e tyre pa raporte. Pra ne duhet të dimë se ato çështje që nuk janë realizuar në vitin e kaluar, ti fusim në planin e punës për këtë vit. Ne si subjekt nuk jemi pjesë e këtyre komiteteve, andaj në bazë të raporteve duam të dimë se çka po punohet aty. Cila është puna e tyre që e kanë bërë gjatë vitit 2019?

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë e hedhi në votim Planin e Punës së Komitetit për Diasporë. Kush është për?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me këtë votim aprovohet edhe Plani i Punës së Komitetit për Diasporë.

Kalojmë për Planin e Punës së Komisionit të Aksionarëve. E hapi debatin.

Mbase s'ka diskutues e hedhi në votim Planin e Punës së Komisionit të Aksionarëve. Kush është për?

Për: 12

Kundër: 0

Ambstenim: 6

Me këtë votim aprovohet edhe Plani i Punës i Komisionit të Aksionarëve.

Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/654 datë: 27.11.2019, për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020. Fjalën e ka Edona.

Edonë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Do t'ju flas shkurtimisht për Programin Komunal për Riintergrim të Qëndrueshëm për Personat e Riatdhesuar për vitin 2019-2022. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka të aprovuar strategjinë shtetore për intergrimin e qëndrueshëm për personat e riatdhesuar për periudhën 2018-2022 dhe planin për zbatimin e strategjisë për vitin 2019-2020. Në kuadër të agjendës evropiane të Kosovës, kriteret nga udhërrëfyese për liberalizim të vizave për përcaktuar në bllokun 0, ripranimi dhe riintergrimi tashmë është përmbyshur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Intergrim janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga programi kombëtar për zbatimin e MSA-së. Kjo strategji ka për qëllim riintergrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv dhe efikas të shërbimeve të fokusuara në nevojat e të kthyerëve. Kjo

strategji është obligative që të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe hartimi i planeve komunale për riintegrim të qëndrueshëm. Për këtë Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me drejtoritë komunale si dhe përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare si grup punues kanë hartuar Planin Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm në Komunën e Malishevës. Plani i Veprimit i përmbanë objektivat, aktivitetet konkrete, skatëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktiivitet, koston e përafërt finaciare, indikatorët matës etj. Shpresoj që ta miratoni këtë plan sepse të gjitha komunat tjera e kanë dhe mendoj që është i nevojshëm edhe për ne.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Këto strategji janë të mira në letër, mirëpo zbatimi i tyre as që ndodh në praktikë. Uroj që tani e tutje kjo strategji të marrin jetë edhe në praktikë.

Këso strategji na kanë ardhur edhe më heret këtu siç ishte ajo për Eficiencën e kurrë raportime nuk po kemi mbi zbatueshmërinë e tyre. Është mirë që ju t'ju përkushtoheni përgjegjësi që keni dhe kryeni detyrat sipas orientimit të kësaj strategjie sepse mbas një kohe sigurisht që do ta kërkojmë edhe një raport.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë shkojmë me procedurat e votimit. Kush është pro aprovimit e Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020?

Për: 19 (unanimisht)

Me këtë votim aprovohet Plani Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020.

Kalojmë në pikën e 15-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Ne si Zyrja e Kryesuesit të Kuvendit e kemi përgatitur një raport të punës 1-vjeçare të Kuvendit të Malishevës. Konsideroj që Kuvendi ka qenë shumë efektiv në punën dhe ka përmbushur obligimet në interes të qytetarëve të K. së Malishevës.

Gjithesëj Kuvendi ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, ka nxjerrur 4 rregullore, 144 vendime, ka mbajtur 3 mbledhje solemne dhe 6 mbledhje të jashtëzakonshme. Të gjitha këto i keni të pasqyruara në raport të cilin e keni para vetës.

Për herë të parë Kuvendi Komunal ka mbajtur dëgjime publike për buxhetin që konsideroj që ka qenë njëri ndër obligimet më të rëndësishëm të punës së tij.

E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: Jemi duke diskutuar për raportin vjetor të punës së Kuvendit, e Kryesuesi tha që kemi mbajtur 12 mbledhje të rregullta. Kryesues ne kemi mbajtur dyfishin apo trefishin e këtyre mbledhjeve sepse këto mbledhje kanë zgjatur 2-3 ditë. Ne kemi marrë vendime të njëjta nga 2-3 herë sepse ndonjëherë na kanë kthyer prapa MAPL-ja, pra i bie që administrata e Kuvendit nuk

ka funksionuar ashtu siç duhet sikurse sot që i patëm 5. Tani ku është faji tek Ekzekutivi apo tek Kuvendi?!

Në këtë raport janë të pasqyruar edhe puna e komiteteve dhe komisioneve të këtij Kuvendi dhe për shkak të të mosrespektimit të numrave që na takojnë ne si NISMA nuk marrim pjesë në këto komitete e komisione, me këtë rast edhe kemi kursyer buxhetin e Komunës.

Sa i përketë mbledhjeve solemne kam një sugjerim për kolegët që të jenë më shumë të pranishëm sepse edhe pse janë solemne ne e kemi për obligim të jemi të pranishëm në këto mbledhje dhe t'i japim më shumë kuptim siç e meritojnë këto data historike.

Sa i përketë komiteteve dhe komisioneve që janë formuar nga ky Kuvend është mirë se të raportohet për punën e tyre dhe të shohim rezultatet e pritura sipas planit të punës së tyre.

E përshendes punën e të gjithë asambleistëve për vitin 2019 në këtë Kuvend, falemnderit!

Alban Mazreku: Ashtu siç e tha edhe Sylja, ne kemi mbajtur mbledhje më shumë se çdo Kuvend Komunal i Kosovës. Në emër të grupit të PDK-së rekomandoj që të gjitha vendimet që i kemi miratuar ne si Kuvend t'u sillen të gjithë asambleistëve. Kërkoj që ky rekomandim të votohet dhe të mbledhjen tjetër t'na sillen këto vendime.

Alban Krasniqi: Sylja e përmendi mospraninë e tyre nëpër komitete ne i bëjmë thirrje që të marrin pjesë dhe të japim të gjithë kontributin tonë si subjekte politike të dobi të qytetarëve në Kuvend.

Në pjesën e sifidave është përmendur pak a shumë në këtë raport pjesa e informimit, mungesa e zërimit dhe transmentimi drejt për së drejti i mbledhjeve. Pra këtu duhet të përmirësohet gjendja, pra të rregullohet çështja e publikimit të vendimeve në veb-faqe, plus është mirë që ne ti kemi edhe ato vendime siç kërkoi me plot të drejtë Albani.

Njëra ndër sfidat tjera Kryesues e që duhet të rregullohet në të ardhmen është që të funksionalizohet Warlesi mbrenda sallës së Kuvendit e secili prej neve të ketë qasje aty që të mund të hartojmë kërkesat tona po çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit, pra këto janë kushte bazike për të bërë punën tonë në Kuvend.

Kryesues, puno që të gjitha këto si sfida që i ke paraparë që të rregullohen sa më shpejt e seriozisht merru me ato. Nëse ke mungesë të stafit tre, nëse ke mosbashkëpunim në mes të Kuvendit dhe Ekzekutivit trego, por në një afat sa më të shkurtër këto sfida të realizohen e të mos jenë më. Duhet që secili anëtar i Kuvendit të paiset me mjetin e identifikimit si dhe me afatin e mandatit, të rregullohet salla e në veçanti karriget të cilat janë të prishura që sa kohë etj.

Arbëreshë Krasniqi: Sa i përketë këtij raporti i përgezohet të gjithë asambleistët e kësaj Asambleje sepse janë shumë puntorë! Kam vërjetje për Kryesuesin e Kuvendit i cili nuk ka bashkëpunuar me Kryetarin e Komunës e që konsideroj që është shkelje ligjore e punës dhe e përgjegjësisë si kryesues i Kuvendit. Mendoj që është stërtepruar me seanca të shumta dhe të stërzgjatura të këtij Kuvendi dhe me këtë nuk i kemi ndihmuar procesit dhe në shumë raste e kemi penguar procesin dhe mundësinë e zhvillimit të projekteve të K. së Malishevës. Nuk do të

doja që opozitën e bashkuar ta shoh në një situatë të tillë! Nga kjo kemi pasur ne si NISMA shumë pengesa në qeverisjen e Komunës dhe në realizimin e shumë projekteve.

Një ndër problemet që kemi hasur në këtë Asamble është edhe pengesa e shumë ndaj këshillëtarëve të NISMA në foltore gjat debateve tona duke ndërhy me fjalë fyese dhe termologji fjalësh të ulta. Megjithatë ne me një qetësi i kemi rezistuar edhe kësaj. Kryesues edhe këtë çështje është dashur ta monitorosh e ta përcjellësh me një seriozitet më të madh me të cilën po ballafaqohemi në secatat e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Mbledhjet e stërzgjatura ku janë 27 mungesa për 12 seanca. Me të vërtetë e humbasin kuptimin kur mbledhjet mbahen deri 3 ditë sepse jo gjatë debatit janë trajtuar çështjet që i përkasin rendit të ditës e sidomos secili nga ne i di diskutimet e stërzgjatura të Alban Krasniqit. Kryesues kërkoj që mos të ndërhyjnë gjatë fjalimit tim. Alban, mos më pengi kur të flas, unë ty të dëgjova dhe nuk të pengova!

Është mirë që ne si Asamble të diskutojmë, të bashkëpunojmë e të marrim vendime ashtu siç i ka hije kësaj Asambleje. Faleminderit!

Valon Krasniqi: Me dy parafolet ka disa pika që nuk pajtohem sepse nuk mund të luajmë me intelegjencën e qytetarëve. Albani tha që ne kemi një pagë pothuajse simbolike dhe nuk i krijojmë vetës avantazh që bëjmë aktivitete për interesat e qytetarëve. Pa marrë parasysh se çfarë partie politike i përkasim, kjo nuk qëndron te gjithë por te një pjesë e asambleistëve, opinioni duhet të informohet drejt dhe qartë sepse shumica e asambleistëve të pozitës i mbajnë nga dy apo tri pozita pune si politike ashtu edhe fusha të tjera.

Kryesues, kërkoj që mos t'ëmë ndërhyjnë kur të flas!

Sa i përket investimeve dhe projekteve jo veç grupi ynë, por as edhe opozita nuk ka qenë bllokuese. Ne nuk jemi fajtorë që 7 zyrtarëve ju ka ngritur aktakuzë nga gjyakta në Gjakovë. A është opozita fajtorë që të gjitha projektet e parapara për vitin 2019 nuk i keni përfunduar?! Opozita nuk është penguese e asnjë procesi, përkundrazi kemi kontribuar në çdo lëmi.

Rrahim Morina: Ju lus për një debat të qetë dhe të sinqertë pa fytyrje dhe ndërhyrje gjatë debateve!

Sylë Dukolli: Kryesues, është mirë që kushdo që flet këtu të mos flas për njerzit që nuk i njeh. Mos të nxjerrin këtu klithma dhe të tregojnë këtu psikopati. Unë askënd nuk e fyve! Të dy kemi ardhur me vota të popullit dhe duhet respektuar vendimi i tyre.

Rrahim Morina: Nuk është mirë që të bini në situata të tilla. Fattikisht Arbëresha çdo herë e nxit Kuvendin sepse flet për disa gjëra që nuk janë reale dhe të vërteta. As mua nuk pom pëlqen Albani se si po ndrhynë gjatë debateve, është mirë që të debatojmë në mënyrë demokratike dhe parlamentare.

Kastriot Berisha: Kërkoj nga kolegët që ta respektojnë njëri-tjetrin gjatë debateve. Po i përmend disa projekte milionshe siç është pishina olimpike, unaza e qytetit, parku i biznesit e mos të luajmë me projekte të tilla milinonshe, kur qytetarët kanë nevojë për gjëra elementare. Askush nuk është kundër këtyre projekteve, por pasi të përmbushen kushtet elementare. As një qeveri që sa kohë nuk ka qenë në gjendje që të rrethi në Malishevë ta rregulloj kapakun e shaktit e që kushton para pak. Pra investimet që përmendet ju Arbëreshë që po e luan rolin e melaqes, është veç edhe ndonjë hajni të bëhet, sepse asnjë projekt nuk është përfunduar si duhet, shembull e keni minitranzitin që 2 vite është ndërtuar dhe aty mexi që kalohet për shkak të punës shumë të dobët.

Kryesues, nuk edi pse po e kërkon praninë e Kryetarit këtu kur e dimë se çdo ditës ai është në gjykatë, mos është pak e tepërt kjo?!

Arbëreshë Krasniqi: Nëse diskutojmë se kush sa ka përfituar dhe nëse e shohim se kush ka pasuri milionshe në mesin e atyre jeni edhe ju Kastriot. Më vjen keq, por mos shit moral pasurus këtu për mua është e papranueshme!

Çështja se kush po e dhez Kuvendin këtu, Kryesues është mirë që t'i shihni puntë e juaja dhe çka ne këtu diskutojmë është çështje e jona. Ne nuk do ta lejojmë një diskutim të tillë!

Çështja se kush po e luan rolin e dreqit dhe të melaqes Kastriot ne mund ta diskutojmë sa të duash, ju e dini sa sa vërjetje kam pasur për mungesë të drejtorëve dhe raportet që kanë ardhur këtu. Kujdes me atë se çfarë diskutoni këtu! Mos ofendoni!

Kastriot Berisha: Malisheva është shumë e vogël dhe të gjithë e dinë kush jam unë, kush është Arbëresha e të tjerët. Të gjithë e dinë kontributinë tonë. Prej mbasluftë e gjithë familja jem nuk ka marrë asnjë cent nga shteti, dhe asnjë nuk punojmë në punë shteti. Ne kemi firma private dhe punojmë me nder. Nëse ka marrë ndokush atëherë është Arbëresha sepse në të njëjtën kohë ka punuar mësues, në Asamble dhe në Ministri. Në qoftëse dikush e ngrryen shtetin janë shumica e Asmbleistëve të NISMA sepse i kanë nga 2-3 paga mujore.

Rrahim Morina: Ju lutem fokusohi tek tema e ditës, mos u lëshoni në debate familjare.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Këto situata që po krijohen në Asamble nuk e ndihmojnë askënd, atëherë mos të leshohemi në debatete të tilla, por të flasim për atë se për çfarë jemi të thirrur këtu.

Ky rpaort është copy-paste i seancave të thirrura, vendimet që janë nxjerr etj, pra nuk përmbanë asgjë më shumë dhe si i tillë është raport i zbrazët. Kemi disa probleme që po shfaqen gjatë mbledhjeve sikurse nuk bëhet implemtimi i Rregullores së Punës së Kuvendit. Ai implemteim është për dikë “nënë e për dikë njerke”, mosrespektimi i minutave gjatë fjalimit, ndërhyrja nga vendi në kur flasim, mbledhjet e panevojshme të thirrura, stërzgjatjet e mbledhjeve etj. Ky Kuvend mund të mbahet mend edhe për nxjerrjen e vendimeve të jashtëligjshme e kji ka ndodhur duke u thirrur në arrogancën e votës opozita.

Kryessues, kërkoj nga ju që të jeni më gjithëpërfshirës dhe të mos mbani anime politike në mënyrë që Kuvend të funksionoj ashtu siç duhet.

Rrahim Morina: Jam munduar që të jem i paanshëm politikisht. Alban, salla do të rregullohet shumë shpejt dhe ju mund të flisni nga vendi. Kryetari pak e hiq nuk bashkëpunon me mua ashtu edhe drejtorët nuk vinë në takime kur i thirrimi në përjashtim të disa rasteve. Por me gjithë këto pengesa unë do të përpiqem që të jem në nivel të detyrës dhe të bashkëpunojë me ju dhe jam i gatëshëm që ta respektoj Rregulloren e Punës së Kuvendit pikë më pikë.

Kalojmë në pikën 16-të të rendit të ditës: Formimi i Komisionit për Hartimin e Rregullores për Kriteret e Ndarjes së Çmimeve, Dekoratave dhe Mirënjohjeve. A po pajtoheni se secil subjekt politik ta këtë në këtë komision nga një përfaqësues dhe një anëtarë i këtij komisioni të jetë përfaqësuesi i Kryetarit dhe një përfaqësues nga shoqatat e dalura nga lufta. A po pajtoheni me këtë? Kush është për?

Për: 16 (unanimisht)

A di keni propozimet sot? Mirë, atëherë propozimet i lëmë për mbledhjen tjetër.

Kalojmë në pikën e 17-të të rendit të ditës: Gjendja aktuale në Gjimnazin "Hamdi Berisha" në Malishevë. Drejtori i Arsimit është këtu, ai e ka fjalën dhe na njofton me gjendjen e gjimnazit pas burgosjes së drejtorit.

Blerim Thaçi: Nuk ka ndonjë gjendje aktuale në gjimnaz. Gjimnazi mban mësimin normalisht, ka organizimin e duhur, ka zëvendës drejtorin, sekretarin, pedagogën, psikologun. Jeni të njoftuar edhe me rastin e fundit. Komuna dhe Kryetari i ka marr të gjitha masat ligjore ndaj veprimit që ka ndodh. Tash jemi në pritje të lejimit për emrimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit dhe e tëra është kjo.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Çfarë përgjigjie të ëmbël për një çështje aq të shëmtuar! Para një viti ne si Kuvend nxorëm disa rekomandime ku kërkuam që të shkarkohen drejtorët. Fjala ishte për këtë drejtor dhe për atë të shkollës fillore në Malishevë pasi kishin bërë shkelje të shumata të detyrave të drejtorit. Ne e dimë se ashtu siç vendosen drejtorët e drejtorive në komunë ashtu vendosen edhe drejtorët e shkollave pra në baza partiake. Ne këtë çështjen e drejtorit të gjimnazit e kemi diskutuar shuëm herë sepse ai nuk ka plotësuar asnjë kriter për të qenë drejtor aty. Asaj shkolle i besojnë 1500 familje sepse i kanë fëmijët e tyre aty, por fati e deshti që u zbulua 1 nga shumë shkelje që janë bërë aty. A e dini që ka pas raste kur janë mbyllur ngacmimet seksuale që kanë ndodhur në atë shkollë? Këtë vendim që e ka marr gjykata e ka vë në vend shqetësimin tonë dhe ju gjatë gjithë kohës keni qenë të informuar për të gjitha shkeljet dhe për këtë ju është dashur të jepni dorëheqje Blerim. Kjo është përgjegjësi e jotja, sepse ju merrni me mbarvajtjen e mësimi, kushtet në shkolle, stafin, drejtorët, nxënësit, cilësia në arsim etj. Drejtor, ti i di edhe shumë gjëra

tjera lidhur me fushën e arsimit ku bëhen shkelje e nuk vepron. Ky është dëm për të gjithë qytetarët sepse të gjithë kemi fëmijë nëpër shkolla.

Drejtor, sa shkolla janë me ushtrues detyre dhe që sa kohë e ushtrojnë këtë të drejtë? Pse nuk i ke shpall vendet për drejtor të shkollave?

Drejtor, si është “Qendra e Kompetencës”? A ka drejtor ajo shkollë? Pse nuk është më drejtori aty? Cilat janë arsyet pse nuk është më? Sa shkolla tjera kanë probleme të tilla? Cilat janë masat që po i merrni? Është mirë që të merrni seriozisht me probleme të tilla, dil diskutoj këtu e bëje një raport të veçantë për këtë, përndryshe nëse nuk e menaxhon siç duhet këtë fushë atëherë jep dorëheqje.

Raimonda Krasniqi: Për shkak të parregullësive, shkeljeve ligjore dhe atyre krimeve në këtë Asamble ne kemi kërkuar largimin e dy drejtorëve të shkollës fillore në Malishevë dhe të gjimnazit “Hamdi Berisha”. Për drejtorin e shkollës fillore, drejtori i Arsimit u arsyetua që mos ta ngaxojmë sepse po del në pension. Ndërsa për drejtorin e gjimnazit, përkundër të gjitha veprimeve që ju vet e keni stikulluar, nxitur dhe e keni ndërruar atë shprehjen “qershija mbi tortë” në “eksplozivi mbi tortë”. Ndodhi ajo që ndodhi dhe drejtori këtu nuk shprehi shqetësim sepse kemi të bëjmë me 1500 nxënës dhe që 2 muaj nuk ka ndërmarrë asgjë. Çfarë është duke ndodhur atje? Cila është arsyeja që ju nuk keni ndërmarrë asgjë? Kjo tregon që sa jo serioze e keni marrë ju këtë punë.

Për çështjen e largimit nga puna pasi ju jeni bërë drejtor, unë vet kam marrë pagesë për çëshjen e shkeljeve ligjore që keni bërë ju drejtor. Këto para nuk janë marr nga xhepi juaj, por nga buxheti i komunës e ku po dëmtohen qytetarët.

Konkursi në shkollën “Imer Krasniqi”, mua shqetëson sepse ka 5 vite që jam me gjysmë norme e që 17 vite që punoj në arsim s’ka asnjë ankesë ndaj meje. Që 6 muaj ka dal në pension mësuesi Sejdi Hoti, çka është bërë me ato orë? Unë bëj kërkesë në DKA dhe drejtori më kthen një përgjigje injoruese që s’ka orë. Ku janë orët? Konkursi nuk është shpallur, e ju keni marrë nga tjetër shkollë mësimdhënës dhe i keni bërë orë aty në atë shkollë.

Që sa muaj në shkollën fillore “Ibrahim Mazreku” është me ushtrues detyre, i ka bërë 8-9 muaj. Sa është koha që duhet të jetë me ushtrues detyre një shkollë? Ju këtë ligj e keni shkelur dhe e keni bërë sipas rregullave të juaja. Ne si grup i PDK-së i kemi paraqitur disa rekomandime dhe mund t’ju japim edhe me shkrim.

- Të shpallet konkursi për të gjitha shkollat në K. e Malishevës të cilat nuk kanë drejtorë
- Të bihet lista për të gjithë personat që kanë qenë ushtrues detyre deri tani. Sa është koha, sa muaj që ata që kanë qenë ushtrues detyre
- Të angazhohet Inspektoriati që të vizitoj shkollat për gjendjen higjieno-sanitare në shkolla e sidomos në shkollat që kanë numër shumë të madh të nxënësve
- Të sjellet në Asamble dokumenti se si është veperuar për lëndët e mësimdhënsit që është pensionuar në muajin tetor Sejdi Hoti.

Halil Morina: Pershendetje për të gjithë! Mbase jam puntor i gjimnazit e ndjeva për obligim që të dal këtu e të flas. Asnjëherë nuk e kam amensuar dhe as që e amensoj këdo që ka bërë ndonjë keqpërdorim. Mendoj që këtë pikë të rendit të ditës e keni bërë që ta shfrytëzoni politikisht se sa është shqetësimi aq i madh për këtë çështje. Pika e rendit të ditës: Gjendja aktuale në Gjimnazin “Hamdi Berisha” në Malishevë, duket sikur aty është krijuar ndonjë gjendje e veçantë apo ku ta dijë se çfare. Askush nuk e di se si do të veprojnë një person në të ardhmen, dhe pozicionet merren në bazë të kriterëve të caktuar. Për ne vendimet e gjyësorit janë të mirëqenura dhe i respektojmë ato. Ne nuk punojmë me standarde të dyfishta. Atje nuk bëhet agjë më shumë përveç që mbahet një mësim ashtu siç i ka hije çdo shkolle.

Arbëreshë Krasniqi: Nuk duhet që ti përgjithësojmë problematikat, ashtu siç nuk duhet t'i fshehim problematikat. Ne duhet t'i diskutojmë problematikat dhe t'ju japim konetacionit e duhur. E di që në të kaluarën temë e tillë ka qenë ‘Qendra e Kompetencës’ e në qeverisje lokale ka qenë PDK deri sa kam shkuar me punu aty dhe e kam parë se nuk është ashtu se çka thuhet. Aty punohet. Po dua të besoj që edhe ne gjimnaz bëhet punë e përkushtuar dhe cilësore nga të gjithë mësimdhënësit. Binduni që përgjithësimet e tilla se si po diskutohet këtu i bëjnë dëm K. së Malishevës.

Kërkoj që Drejtoria e Arsimit në Malishevë që të gjitha rastet në cilin do variant të punojë e të verpojnë sipas procedurave ligjore qoftë edhe në shpalljen e konkurseve, plotësimit të orëve etj.

Filloreta Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Në gjimnazin “Hamdi Berisha” ka akademikë dhe profesionistë të arsimit. Ka profesor që 5 vite nuk ka asnjë mungesë, kjo është për t'u çmuar. Ka nxënës që kanë arritur në gara rezultate të mira si në nivel vendi ashtu edhe jashtë. Nuk dua të diskutoj për rastin e drejtorit sepse janë organet e drejtësisë që të merren me raste të tilla. Një gjë ju garantoj që mësimi po mbahet me rregull, nuk ka orë të humbura dhe punohet me nder. Cildo le të gjykohet për veprën e vet dhe përgjegjësia është individuale. Kolektivi i gjimnazit e ka mbajtur gjimnazin dhe edhe sot kolektivi e mbanë gjimnazin.

Rrahim Morina: Meqenëse i takojë sektorit të arsimit dua edhe të diskutojë për këtë temë. Pajtohem me Filloretën që në gjimnaz ka puntorë të vyshëm, të sinqert, por nëpër shkollat në Malishevë kanë ndodhur disa skandale që nuk janë marrë masa. Të gjithë i dimë rastet, me emër e mbiemër. Rasti tjetër është ai i puntorëve me diploma falso që sot punojnë në arsim e të gjithë para tyre i kemi mbyllur sytë. Fatkeqësia më e madhe tek ne është emrimi i drejtorëve që zgjidhet ai që ka muhabet me Kryetarin e Komunës, apo të partisë. S'dert nëse i takon politikës, po le të jetë njeri i ndershëm e puntorë. Kjo është e dëmshme dhe ne duhet t'i luftojmë dukuritë negative. Hajdeni bashkarisht t'i luftojmë këto dukuri. Kurrë mos e mbronin të keqen, sepse shtylla kryesore i një shteti është arsimi. Gjithëmonë e kam thënë se kur dy aplikantë janë me kualifikime të barabarta merrenu të partisë së juaj, por jo me marr edhe njerëz që i bëjnë dëm arsimit dhe shoqërisë.

Blerim Thaçi: Gjendja në arsimin e Malishevës asnjëherë nuk ka qenë më mirë se sa është tani. Alban, shumë gjëra që sot i kërkojnë këtu sikur t'i kishte kërkuar në Prizren do të thoja "të lumtë". Atje ke shumë skandale të tilla, i ke të arrestuar dy zyrtarë etj, pse në aspektin shoqëror këto nuk ja rekomandon Mytaherit?

Çështjen e ushtruesëve të detyrës këtu e kam saruar shumë herë. Janë 6 ushtrues detyre e për me shpall vend pune duhet që MAPL-ja të jep pëlqim për këtë vend pune.

Ju nuk jeni organ që me të nxjerrni rekomandime për të shkarkuar ndonjë drejtor prej pune. Pa dhanë vendim gjykata a është i vërtetë ai rast une nuk mund të marrë masa disiplinore ndaj një punëtori veç me rekomandimet e juaja. Atë ditë që Kryetari është njoftuar nga Komandati i Policiës, ai ka nxjerrë një vendim për shkarim nga detyra e drejtorit personi në fjalë.

Rrahim Morina: Falemnderit për pjesëmarrje, me kaq seancën e shaplli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 15.40

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kryendit: Rrahim Morina